

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

VENDIM

Nr. 17/2021

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR AGJENCINË E MBIKËQYRJES POLICORE”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektligjit “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Sigurinë Kombëtare të bëhet në datat 22-26 shkurt 2021.

III. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktohet komision për dhënie mendimi.

IV. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 4.3.2021.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 15.2.2021